LIGJ
Nr.7382, datë 8.5.1990

PËR AVOKATINË NË REPUBLIKËN POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Avokatia ka për detyrë t'u japë ndihmë juridike shtetasve shqiptarë a të huaj, institucioneve, ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore, organizatave shoqërore, si dhe personave juridikë të huaj. Në plotësimin e detyrave të saj, avokatia i shërben mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, edukimit të tyre me frymën e respektimit e të zbatimit të përpiktë të ligjeve e rregullave të bashkëjetesës socialiste, parandalimit të shkeljeve të ligjeve dhe të mosmarrëveshjeve juridike civile.

Neni 2

Avokati ushtron detyrën e tij, duke marrë pjesë si mbrojtës, në hetuesi dhe më gjykimin e çështjeve penale, ose ne përfaqësimin e pjesëmarrësve në proces në gjykimin e çështjeve civile, në arbitrazh, në organe të tjera shtetërore për çështje civile a administrative, si dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj. Ndihma juridike jepet me këshillime për çështje ligjore me shkrim, me gojë, me përgatitje të kërkesëpadive ose të kërkesave për ndjekje penale, me përgatitje të kërkesave ankimore kundër vendimeve gjyqësore, si dhe me përgatitje të kërkesave e ankesave të tjera të shtetasve.

Neni 3

Avokatët bashkohen në kolegjet e miratuara nga Ministri i Drejtësisë, i cili përcakton edhe juridiksionin ku shtrihet veprimtaria e tyre.

Kolegji i avokatëve është person juridik.

Neni 4

Organi më i lartë i kolegjit të avokatëve është mbledhja e përgjithshme e anëtarëve, nga e cila zgjidhet kryesia prej tre vetësh. Në rrethet ku kolegji ka më pak se 10 anëtarë, zgjidhet një drejtues i cili përfaqëson kolegjin në marrëdhëniet me persona të tjerë, si dhe organizon e drejton punën në kolegj.

Neni 5

Pranohen si anëtarë të kolegjeve të avokatëve shtetasit që kanë arsimin e lartë juridik dhe një vjetërsi pune si juristë jo më pak se 3 vjet. Përjashtimet për rregullin e vjetërsisë së punës si jurist bëhen nga ministri i Drejtësisë.

Neni 6

Pranë Ministrisë së Drejtësisë verpon këshilli mbikëqyrës, i cili përbëhet nga ministri që e drejton, nga zëvendësi i tij, drejtori i drejtorisë ose kreytari i degës përkatëse dhe 4 anëtarë të kolegjeve të zgjedhur nga mbledhja e të gjitha kolegjeve të avokatëve.

Këshilli mbikëqyrës, me nismën e vet ose me propozimin e mbledhjes së përgjithshme të kolegjit përkatës të avokatëve, vendos për pranimin e një juristi si anëtar të kolegjit.

Gjithashtu, me vendim të këshillit mbikëqyrës, mund të aktivizohen juristë si avokatë pranë kolegjeve për një afat të caktuar për çështje konkrete, sipas rregullave të parashikuara në rregulloren për avokatinë, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 7

Avokati, në cilàësinë e tij si përfaqësues ose si mbrojtës ka të drjetë të ndjekë çështjen në të gjitha organet shtetërore e organizatat shoqërore dhe të kërkojë prej tyre njoftime e dokumente që kanë të bëjnë me personin që ai përfaqëson a mbron, ose me çështjen, në të cilën ai vepron si përfaqësues a mbrojtës. Organet shtetërore e organizatat shoqërore detyrohen ta plotësojnë këtë kërkesë të avokatit.

Neni 8

Avokati është i detyruar të përdorë të gjitha mjetet e lejuara nga ligji për mbrojtjen e të drejtave e të interesave të ligjshme të shtetasve shqiptarë a të huaj, si mbrojtës ose si përfaqësues i tyre, si dhe të organeve shtetërore, institucioneve, ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore e të organizatave shoqërore që ai përfaqëson, duke respektuar ligjshmërinë socialiste.

Neni 9

Nuk lejohet që avokati të marrë përsipër dhënien e ndihmës juridike si përfaqësues a mbrojtës, kur me hetuesin, prokurorin a gjyqtarin, që shqyrton çështjen, është gjini ose krushqi e afërt. Gjithashtu, ai nuk lejohet të marrë përsipër dhënien e ndihmës juridike, kur ka marrë pjesë më parë në të njëjtën çështje si hetues, prokuror, gjyqtar, ekspert e dëshmitar.

Avokati ndalohet të japë ndihmë juridike ose të përfaqësojë njërën palë, kur më parë ka dhënë ndihmë juridike ose ka përfaqësuar palën kundërshtare.

Neni 10

Avokati nuk mund të pyetet si dëshmitar për rrethana që ka mësuar me cilësinë e tij si përfaqësues a mbrojtës dhe ai të përhapë të dhëna që i ka mësuar gjatë kryerjes së detyrës së tij për dhënien e ndihmës juridike.

Neni 10

Avokati nuk mund të pyetet si dëshmitar për rrethana që ka mësuar me cilësinë e tij si përfaqësues a mbrojtës dhe as të përhapë të dhëna që i ka mësuar gjatë kryerjes së detyrës së tij për dhënien e ndihmës juridike.

Neni 11

Avokati ka të drejtë të japë ndihmë juridike dhe të mbrojë të drejtat e interesat e të përfaqësuarve prej tij në organet gjyqësore, tëhetuesisë dhe të administratës në rrethin e të cilëve shtrihet juridiksioni i kolegjit ku bën pjesë, si dhe në gjykatën e zonës e në Gjykatën e Lartë.

Në raste të parashikuara në rregulloren e avokatisë mund të lejohet përfaqësimi i pjesëmarrësve në proces ose mbrojtja e të pandehurve edhe nga avokatë të një kolegji tjetër.

Neni 12

Avokati mund të refuzojë dhënien e ndihmës juridike dhe të heqë dorë nga prëfaqësimi a mbrojtja e filluar, kur ka shkaqe që çmohen të arsyeshme nga kryesia ose drejtuesi i kolegjit. Në të tilla raste ai duhet të ndjekë çështjen deri sa të interesuarit t'i sigurohet mbrojtja e interesave të tij.

Neni 13

Ndihma juridike jepet kundrejt pagesës në bazë të tarifave të caktuara nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe arkëtohet për llogari të kolegjeve. Në raste të veçanta, të parashikuara në rregulloren e avokatisë, ndihma juridike mund tëjepet falas.

Mënyra e ndarjes së të ardhurave caktohet me rregullore të Ministrit të Drejtësisë.

Avokatët gëzojnë të drejtën e sigurimeve shoqërore shtetërore.

Neni 14

Ministri i Drejtësisë ka të drejtë të pezullojë zbatimin e akteve të paligjshme ose të parregullta të mbledhjes së përgjithshme, të kryesisë ose të drejtuesve të kolegjeve të avokatëve dhe të kthejë çështjen për shqyrtim.

Neni 15

Për shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të caktuara për ushtrimin e avokatisë, këshilli mbikëqyrës merr masa disiplinore deri në përjashtimin nga kolegji sipas rregullores për avokatinë.

Neni 16

Ministria e Drejtësisë ndihmon e kontrollon kolegjet e avokatëve në gjithë veprimtarinë e tyre.

Neni 17

Për zbatimin e këtij ligji, ministri i Drejtësisë, të nxjerrë rregulloren përkatëse.

Neni 18

Dekreti nr.4277, datë 20.7.1967 “Për krijimin e zyrave të ndihmës juridike”, shfuqizohet.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi më 1 nëntor 1990.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA